

## ALB STAR SHPK

Data e themelimit : 15 Shkurt 1995  
Numri unik i indentifikimit(NIPT): J62903212W  
Selia: Fier,Tirane

Objekti tregtar: Ndertime Civili ,Industriale,Tregeti ,Import Exporte

# Shenim mbi Pasqyrat Financiare 2020 (Mbyllur më 31.12.2020)

Pasqyra financiare: Te konsoliduara

Periudha kontabel: Nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020

Data e mbylljes:30 MARS 2021

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke

Tiranë, Mars 2021



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**1. Informacione te pergjitheshme**

" ALB-STAR " sh.p.k , eshte themeluar si nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar me vendim te gjykates se rrerhit gjyqesor Tirane nr.8918 date 15 Shkurt 1995 me ortak te vetem z.Sadik ISMAHILAJ .

Me vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 8918/1 date 27 Qershori 2002 eshte bere shitja e e 50% te kuotave te kapitalit tek z. Idajet ISMAILAJ .

\*Me vendimin nr 23 dt 19/09/2016 te Asamblese se perjithshme te ortakeve ,u shkarkuan administratoret aktual te shoqerise Sadik Ismailaj dhe Idajet Ismailaj dhe u emerau si Administrator per nje afat 5 (pese)vjecar nga data 19/09/2016 deri 19/09/2021 Z Edmond SPAHIU  
U shtua Ortaku I vetem (person juridik) FINMAN shpk I cili zoteron tashme (1)nje kuote, me pjesemarrije 100% te kapitalit themeltar te shoqerise prej 85,000,000 leke Numri I perjithshem I kuotave nga 100 u be 1(nje)

Ne baze te Certifikates Deklaruese te TVSH-se me nr.330036592 dhe nr.Fiskal , 600203820 , date 28.01.2010 ,shoqeria " ALB-STAR " sh.p.k , ka hapur nje dege ne Kosove , Prishtine me seli : Kroc I Bardhe , Lokali 47 , Prishtine , Kosove .

Ne baze te Vendimit nr 6-0012137/001 regjistrohet shoqeria" Albstar" Tivat si pjese jashtme e Shoqerise ALB-STAR shpk Shqiperi me dt 25.10.2013.Pjese e vendimit eshte dhe Ekstrakti nga Regjistri Qendror me numer (amë) fiskal 02957449 dt 25.10.2013. dega territoriale 914.

Shoqeria "ALB-STAR" Tivat si pjese jashtme e Shoqerise Alb-Star shpk Shqiperi regjistruar ne administraten tatimore Mali Zi me numer regjistrimi te Tvsh 91/31-01084-8 dt 30.10.2013

**AKTIVITET KRYESOR**

Veprimitaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2020 jane sherbimet ne fushen e ndertimit dhe te infrastruktureve.

**DREJTUESIT**

**BORDI DREJTUES**

EMRI	FUNKSIONI	VENDI
Edmond SPAHIU	Administrator	TIRANE
Elsa SEMA	Drejtore e Dpt Finances	TIRANE

**2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SNRF-të**

Pasqyrat financiare(individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) dhe me kerkset e ligjit "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

**3. Përbledhje e politikave kryesore kontabël të zbatuara.**

Në përgatitjen e tyre janë përdorur kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe parimi i vijimësisë, me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar.  
Paraqitja e tyre eshte bare ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ( Lekë).

**3.1 Bazat e matjes të përdorura**

Bazat e matjes të përdorura në pasqyrat financiare është kosto historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera ( kosto aktuale, vlera neto e realizueshme, vlera e drejtë ose shuma e rikuperueshme) sipas kategorive të aktiveve dhe detyrimeve siç e kerkojne standartet perkatese.

**3.2 Bazat e konsolidimit**

Pasqyrat financiare perfshijne pasqyrat financiare te Shoqërisë dhe filialeve e degeve te saj ( Kosove dhe Mal te Zi) per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor.

**3.3 Politikat e tjera kontabël të përdorura që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.**

**a) Aktivet Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e kostos dhe zbatohet për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale.Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që kualifikohet për njojje si aktiv matet me koston e tij. Mbas njoftes fillestare si një aktiv, çdo element i aktiveve afatgjata materiale mbartet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve rishikohet ne çdo date raportimi dhe kur ekzistojne indikacione që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar, atëherë drejtimi çmon shumën e rikuperueshme të aktivit dhe njeh ate ne perputhje me SNK- 36 Zhvlerësimi i Aktiveve.

Për të shpërndarë shumën e amortizueshme të një aktivi mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme, shoqeria përdor si metodën e zgogëimit te tepricës e cila sjell një ngarkesë rënëse përgjatë jetës së dobishme.Metoda e amortizimit aplikohet në menyre të qëndrueshme, përvèç rasteve kur ka një ndryshim në tiparin e pritshëm të marrjes së përfitimit e ekonomike të ardhshme. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e aplikuara per vitet 2016 dhe 2015 janë :

Ndertesa	5%
Instalime teknike dhe makineri	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

**b) Investimet ne shoqerite e kontrolluara dhe pjesmarjet**

Investimet në njësите ekonomike te kontrolluara dhe ne pjesëmarrje, në pasqyrat financiare individuale, që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje, paraqiten në përputhje me paragrafet 37-42 te SNRF 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale".Ato njihen fillimisht ne kontabilitet me koston e blerjes dhe në pasqyrat financiare pas blerjes, me kosto minus zhvlerësimin. Shoqeria ka njesi ekonomike te kontrolluara, ajo ka hapur filiale dhe dege te saj ne Kosove dhe ne Mal te Zi .

Filialet janë të gjitha entitetet mbi të cilat Shoqëria ka te drejte te drejtoje politikat financiare dhe operative ne menyre qe te perfitoje te mira prej ushtrimit te aktivitetit te tij. Gjate vleresimit te kontrollit, te drejtat e votes qe ushtrohen aktualisht, jane marre ne konsiderate. Pasqyrat financiare te filialeve janë te perfshira ne pasqyrat financiare qe nga data e fillimit te ushtrimit te kontrollit deri ne daten qe ky kontroll merr fund.

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

Tepricat qe rrjedhin nga marredheniet brenda grupit, dhe te ardhurat e shpenzimet e parealizuara qe burojne nga transaksione brenda grupit, jane eliminuar ne momentin qe jane percatitur pasqyrat financiare. Te ardhurat e parealizuara jane eliminuar ne percatitjen e pasqyrave financiare. Shpenzimet e parealizuara jane eliminuar ne te njejtmenyre si te ardhurat e parealizuara, por vetem ne ate mase kur nuk ka tregues per zhvleresim.

**c) Inventarët**

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SNRF-2 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zoteron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Njohja si aktiv e inventareve behet fillimisht me kosto që përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me kostot standarde qe marrin në konsideratë nivelet normale të materialeve, të furniturave, punën, eficencën dhe shfrytëzimin e kapacitetit. Ato shqyrtohen rregullisht dhe, po qe se është e nevojshme, ndryshohen duke marrë parasysh kushtet aktuale.

Në bilanc inventarët maten me shumën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësimë dhe marrin në konsideratë luhatjet e çmimit apo të kostos që lidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet që ndodhin pas mbylljes së bilancit. Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja.

**d) Aktivet financiare**

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kerkesa te arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kerkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kerkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për tu arkëtar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënien vlore të të drejtave për tu arkëtar krijohet atëherë kur ekzistojne rethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtushme për secilin klient.

Kërkesa te tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përvëç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtushme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

**e) Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njoitura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimitari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimitari investuese janë blerja, dhe nxjerra e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimitaria financiare, dhe si rrjedhim

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

**f) Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata**

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SNK-1, "Paraqitja e Pasqyrave Financiare".

Huamarjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit dhe me pas vlerësohen me koston e amortizuar. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, perveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë te pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre te llogaritur sipas kërkësave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferençë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

**g) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Zakonisht të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe, si dhe efektet e ndryshimeve në çmuarjet kontabël, përfshihen në fitim ose humbje. Megjithatë mund te ekzistojnë rrethana që një zë i veçantë përjashtohet nga fitimi ose humbja e periudhës aktuale, në zbatim te kërkësave te SNK - 8 dhe standardeve të tjera.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë duke marrë parasysh shumat e uljeve dhe zbritjeve tregtare të përfituar. Ato njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtët ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

**h) Transaksionet me monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit.. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 janë :

EURO : LEK 123.7

USD : LEK 100.84

CAD : LEK 79.14

**k) Tatimi aktual mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem per vitin. Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai perjashton zera te te ardhurave dhe shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjere dhe gjithashtu perjashton zera qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem. Detyrimi i shoqerise per tatim fitimin e viti illogaritet duke përdorur normat e tatimit te percaktuara nga legjislacioni shqiptar, ate te Kosoves dhe Mali Zi per kontabilitetin ne Shqiperi, Kosove dhe Mali Zi. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin ne Shqiperi eshte 15% (2020-15%) Norma aktuale e tatimit mbi fitimin ne Kosove i eshte 10% (2020-10%)

Ne baze te ligjit te Malit te Zi norma e fitimit eshte 9% (2020-9%)

Per shkak se nuk ka diferenca të përkohshne në njohjen e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, atehere nuk rezulton aktiveve tatimore të shtyra apo detyime tatimore të shtyra.

## SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

## 5. Mjete Monetare (likujditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne fillim dhe fund te ushtrimit jane si me poshte:

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Monedha	Viti reportues	31.12.2020	Viti reportues	31.12.2019
			Leke	Valute	Leke	Valute
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	83,524		89,688	
2	Mjete monetare në bankë	Lekë	272,582,178		58,265,352	
3	Mjete monetare në bankë	Euro	608,640,810	4,920,298 €	167,675,667	1,376,987 €
4	Mjete monetare në bankë	USD	22,964,796	\$ 227,735	5,159,793	\$ 47,494
5	Mjete monetare në bankë	CAD	36,444	£ 461	41,356	£ 496
Shuma			904,307,752	-	231,231,856	-

Gjendjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të ushtrimit.Tepicat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipëri është me 31.12.2020.Llogaria bankare ne euro perbehet nga **4,859,024 euro** ALB-STAR shpk,dhe **0 euro**, ALB-STAR shpk Kosova, dhe **61,274 euro** Albstar Tivat Mali Zi .Arka ne euro perbehet nga: **0 euro** ALB-STAR shpk

## 6. Të Drejtë të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Viti reportues 31.12.2020	Viti reportues 31.12.2019
1	Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)	2,828,753,117	9,205,341,450
2	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit( dividenti)	-	-
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike	632,948,094	1,244,761,201
4	Të Tjera (Debitore të tjera)		
	Shteti-Tatim fitimi i mbartur		13,074,266
	Shteti-Tatim fitimi ushtrimit		
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	462,221,631	459,372,442
	Huadhenie e përkoshme(parapagim blerje)	196,799,069	203,958,790
	Te tjera (furnitore deb dogana+ albsig)	6,432,400	332,040
5	Kapital i Nënshkruar i Papaguar	-	-
Shuma		4,127,154,311	11,126,840,189

Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të arketohen në një periudhe afatshkurtër me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie në vlerë. Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " ne shumen **2828753117** leke , jane pasqyruar vlerat e akumuluara te kerkesa te arketueshme ndaj klienteve,ne shqiperi,kosove,mali zi, per shitjen e mallrave dhe sherbimeve.Ne Llogarine /Interesa pjesëmarrëse shuma **632948094** leke perbehet nga ,mali zi (**596.918**) euro,Ecoclean sha,&,Albral shpk, &IR shpk &,Grabova Hydropower shpk.Te llogaria debitor te tjera (parapagim per blerje)perbehet nga,**196799069** leke qe jane parapagimet per blerje te deklarura alb-star shqiperi.TVSH **462221631** leke perbehet **16455017** mali zi, **26886029** leke kosove Tvsh **418.890,585**,leke shqiperi ,

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**7. Inventari**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti reportues 31.12.2020	Viti reportues 31.12.2019
1.	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	270,136,518	47,125,243
2.	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte	-	-
3.	Produktet të Gatshme	-	-
4.	Mallra	-	-
5.	Aktive Biologjike	-	-
6.	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
7.	Parapagime për Inventar	-	-
	Shuma	270,136,518	47,125,243

. Politikat kontabel per matjen e inventareve eshte bazuar ne SNRF-2 "Inventarët". Fillimisht inventaret mjihen me kosto e blerjes qe përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera,(përveç atyre që njesia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së mallrave,materialeve dhe shërbimeve.

Gjate ushtrimit per daljen e inventareve eshte perdonor metoda "mesatares se ponderuar". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2020 eshte 1.200.589.913 leke(duke perfshire uje+energji elektrike). Klasifikimi dhe vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020.

Vlerat e paraqitura te inventarëve jane matur me shumën më të ulët të kostos mesatare te ponderuar dhe vlerës neto të realizueshme. Çmuarja e vlerës neto të realizueshme eshte bazuar per gjithesish në evidencë të besueshme.

Drejtimi mendon per kete ushtrim kontabel nuk eshte nevoja per te njohur shuma zhvlerësimi të inventarëve.

Nuk ka vlera inventarësh të vendosur si peng për pasivet.

**4. Shpenzime të Shtyra**

Nuk jane evidentuar shpenzime te shtyra ne fund te ushtrimit.

**8. Aktive Afatgjata Financiare**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti reportues 31.12.2020	Viti reportues 31.12.2019
1	Tituj Pronësie të Njësive Brenda Grupit	-	-
2	Aksionet e Veta	-	-
3	Të Tjera Financiare	-	-
	Shuma	-	-

Nuk jane evidentuar Aktive Afatgjata Financiare ne fund te ushtrimit.

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**9.Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)**

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Toka/Terrene	Ndertesa	Impiente dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2020	1,001,282,031	627,255,787	1,645,755,996	100,463,825	4,316,272,974	7,691,030,613
	Shtesat			660,567	1,017,278	2,451,710,583	2,453,388,428
	Pakësimet			(702,159,573)	(92,916,658)	(37,029,463)	-832,105,694
	Kosto e AAM-ve 31.12.2020	1,001,282,031	627,255,787	944,256,990	8,564,445	6,730,954,094	9,312,313,347
							0
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	(210,719,780)	(1,252,673,784)	(92,368,393)	-	-1,555,761,957
	Amortizimi ushtrimit	-	(20,392,644)	(49,445,991)	(9,943,454)	-	-79,782,089
	Amortizimi për daljet e AAM	-		507,298,800	122,121,944	-	629,420,744
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2020	-	(231,112,424)	(794,820,975)	19,810,097	-	-1,006,123,302
							0
C	sistemimAAM-ve 01.01.2020			-	-	-	0
	Shtesat	-		-	-	-	0
	Pakesimet			-	-	-	0
	sistemimAAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	0
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01	1,001,282,031	416,536,007	393,082,212	8,095,432	4,316,272,974	6,135,268,656
							0
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12	1,001,282,031	396,143,363	149,436,015	28,374,542	6,730,954,094	8,306,190,044

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos(SNK-16). Ne koston e njohjes fillestare te një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) jane përfshire çmimi blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të reimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare ose kostoja e ndertimit te tij, si dhe çdo kosto të ngarkueshme drejtperdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Per amortizimin e AAM-ve shoqeria ka zgjedhur metoden e zvogelimit te teprices(amortizim mbi bazen e vleres neto) e cila aplikohet ne menyre te qendrueshme dhe eshte e njejtë me ato qe perdoren per qellime fiskale. Normal e amortizimit të perdorura marrin parasysh jetën e dobishme dhe masa e tyre vjetore sipas grupave eshte shpjeguar ne shenimin nr.3.2.a.

Ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se per gjithesish per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlera te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime

**10.Aktive Afatgjata Jo-Materiale**

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1.Koncesione , Patenta,Licenca,Marka Tregetare		-	-
2.Emri I Mire		-	-
3.Tituj te Tjere Aktive Afatgjata Jo-Materiale		110,612,900	110,612,900
Shuma		110,612,900	110,612,900

Te aktive financiare jane kouta qe perfaqesojne -Albral shpk 89,703,900 leke (albstar ka 85% te aksioneve) , dhe Ecoclear sha 20,841,000 leke (albstar ka 50% aksione), Shushica shpk 34000 leke(albstar ka 34%) & Grabova Hydropower shpk 34000 leke (albstar ka34%)

Alb-Star sh.p.k



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**11.Detyrime Afatshkurtëra**

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Titujt e Huamarjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë(overdraft raiff)	1,267,280,454	565,616,885
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	360,258,205	297,905,579
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	1,500,750,498	7,222,461,187
5	Dëftesa të Pagueshme		
6	Të Pagueshme ndaj (shell,ark 2 here)	9,570,665	4,608,850
7	Të Pagueshme detyrime mali zi	1,202,240	
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shq./shëndet.	53,458,688	54,543,364
	Paga dhe shpërblime	44,210,323	44,594,049
	Sigurime shqërore dhe shëndetësore	9,248,365	9,949,315
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	197,862,680	4,975,294
	Shteti-Tatim mbi fitimin	193,070,177	
	Shteti-Tatim mbi vleren e shtuar (dogana)	58,031	37,639
	Tatim mbi të ardhurat personale	4,354,949	4,693,738
	Tatimi ne burim	379,523	243,916
10	Të Tjera të Pagueshme hua te pjesm Finman	80,656,900	89,040,900
	<b>Shuma</b>	<b>3,471,040,330</b>	<b>8,239,152,059</b>

Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit.Kjo vlore prej 1500750 mijë perbehet nga :**1486132 mijë leke** te ALB-STAR shpk,**14618 mijë lek .** ne Mal te Zi .

Shoqeria ka perqatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2019.,

"**Detyrimet tatimore**" ne shumen **197,862,680 lek**,perfaqesojne detyrimin tatimor ne shqiperi

Ne"Parapagimet e arketuara" shumen **360,258.205 leke** te cilat , pasqyrojne paradheniet e faturuara dhe te arketuara per periudhat e ardheshme ne shqiperi ,

**12.Detyrimet Afatgjata**

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Titujt e Huamarjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	2,510,072,739	2,487,534,661
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytezuese(Furnitore)	-	-
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Tjera të Pagueshme	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>2,510,072,739</b>	<b>2,487,534,661</b>

" Huate afatgjata " perfaqeson kredine te BKT 20,000,000 euro per Arena kombetare ,si dhe te banka OTP kredi lufte 72.5 miljon leke per paga te shoqerise per Alb-Star shpk,e shlyer periodikisht " Huate afatshkurtera,"si dhe ,overdraft te raiff 3000000 euro dhe 7500000 euro te banka OTP

**Alb-Star sh.p.k**



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**14. Kapitali dhe rezervat**

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejtë me ate te percaktuar ne vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2016 ai eshte 85.000.000 leke, i ndare ne 85.000 kuota me vlerë nominale 1.000 leke /kuota.

Raportet e zoterimit te kapitalit te regjistruar per vitin ushtrimor 2020 paraqiten:

Nr	Emertimi	Totali	Person Juridik FINMAN		
			Vlere	Kuota %	Vlere
1	Kapitali regjistruar ne 31.12.2020 Zmadhim-nga fitimet e pashperndara	85,000,000	85000000	100%	-
	Kapitali regjistruar ne 31.12.2020	85,000,000	85,000,000	100%	

**15. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera**

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit: Shitje e produkteve te gatëshe dhe nënprodukteve Shitja e punimeve dhe shërbimeve Shitja e mallrave Të ardhura nga shitje të tjera(qera,komisione,etj)	- 5,808,134,526 - 54,423,092	- 6,468,579,202 - 153,165,791
	Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	5,862,557,618	6,621,744,993
2	Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar		
3	Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit Të ardhura nga Shitia e Aktiveve Afategjata Të ardhura të tjera(divident asab shpk+apm .shpk.)	202,684,952	583,139,502 1,329,655,210
4	Ndryshimi në Inventarin e Produkteve të gatshme dhe prodhim	-	-
	Shuma	6,065,242,570	8,534,539,705

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSHJA.(Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNRF-8).Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre. Të ardhurat nga sherbimet e ndertimit ne infrastrukturre ne vleren 6,065,242,570, leke Jane Alb-Star Shqiperi

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**3.4 Shpenzimet e veprimitarise kryesore**

Informacioni mbi shpenzimet e ushtimit bazohet ne klasifikimin sipas natyres se tyre. Ato paraqiten te grupuara ne zerat; materiale dhe mallra te konsumueshme te përdorura; shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve; shpenzimet e amortizimit; zhvleresimi i tokës, ndërtesave, makineri e pajisje dhe ne zerin shpenzime te tjera. Disa prej tyre jane shpjeguar ne shenimet paraardhese dhe te tjerat jepen në vazhdim. Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyrura ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin Jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

Shpenzimet e tjera qe ne nje mase te konsiderueshme perbehen nga Furnitura, nentrajtime dhe sherbime nga te trete paraqitet e analizuar sipas pasqyres se me poshteme.

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 jane treguar ne pasqyren perkatese

**16. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme**

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme Lënda e Parë dhe Materiale Mallra	1,200,589,913 - -	2,644,570,413 - -
2	Të Tjera Shpenzime <b>SHUMA</b>	<b>1,200,589,913</b> - -	<b>2,644,570,413</b> - -

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyrura ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.

**17. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrija në fitime dhe shpërblimet.

Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :

Kategorite	Ushtrimi 2020 (000 leke)			Ushtrimi 2019 (000 leke)		
	Numer mesatar 2020	Paga 2020	Sigurime punedhenesi 2020	Numer mesatar 2019	Paga 2019	Sigurime punedhenesi 2019
Administrator, me	3	3,950	660	3	4,757	714
Specialist me arsi	423	366,432	54,980	525	418,451	62,767
Teknike	60	25,500	3,825	65	27,800	4,170
Puntore	248	63,240	7,714	352	89,955	13,248
Shperblim		37,168			37,568	
<b>Shuma</b>	<b>734</b>	<b>496,290</b>	<b>67,179</b>	<b>945</b>	<b>578,531</b>	<b>80,899</b>

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Nr mesatar i punonjesve Shqiperi eshte 732 punonje paga &shperblim 495536 mijë leke, dhe kosove 1 e mali zi Nr i punonjesve 1 paga 754 mijë leke, shperblime Shqiperi 37,168 mijë leke dhe kosovs ,mali i zi 0 leke

Sigurime shoqerore Shqiperi 67179 mijë leke,dhe kosove e mali zi zero leke

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**18. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshire kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejprëndrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo regullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
<b>4-Materialet e konsumuara</b>		
a-Lende te para ( 601-608 )	1,200,589,913	2,644,570,413
b-Produkte	0	0
c-Mallra ( 601-608 )	0	0
<b>Shuma</b>	<b>1,200,589,913</b>	<b>2,644,570,413</b>
<b>7-Shpenzime te tjera ( 61-63 )</b>	<b>2,184,080,165</b>	<b>2,862,425,777</b>
Trajtime të përgjitheshme(nga te trete)	1,506,037,051	2,200,969,165
Qera	294,720,247	105,267,398
Mirmbajtje dhe riparime	34,737,093	109,199,500
Sigurime	66,809,112	63,423,556
Publicitet,reklama	5,461,600	1,466,063
Shpenzime juridike	24,177,365	30,783,400
Trasferime,udhëtime,dieta	145,759,051	218,903,778
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	5,821,627	6,357,651
Shpenzime transporti	75,203,997	109,386,187
Shpenzime për shërbimet bankare	25,353,022	16,669,079
Shpenzime për uje e drita		
Te tjera		
<b>Tatime dhe taksa(llog.63)</b>	<b>21,631,782</b>	<b>29,238,439</b>
Taksa dhe tarifa vendore	14,712,366	19,628,899
Taksa te regjistrimit	6,919,416	9,609,540
Tatime te tjera doganore		
<b>Shpenzime të tjera jo korente(llog.67)</b>	<b>202,684,951</b>	<b>629,672,335</b>
Vlera kontabël e AA te shitura	202,684,951	629,672,335
Te tjera	-	-
<b>Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi(Gjoba,provizione) Llog.65,6</b>	<b>18,844,119</b>	<b>16,079,352</b>
Shpenzime per pritje dhe përfaqësime	8,821,290	11,640,033
Gjoba dëmshpërblime	10,022,829	4,439,319
Provizione (klient I paarketueshem)		
Te tjera (shpenz te panjohura nga invst)		
<b>Shuma</b>	<b>2,427,241,017</b>	<b>3,537,415,904</b>

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin Jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Nga Vlera e Qera 294,720,247 leke, 24.552.571 leke eshte totali i qerave mbi te cilen llogaritet tatim ne burim

Shpenzimet e tjera qe ne nje mase te konsiderueshme perbehen nga Furnitura, menjtamente dhe sherbime nga te trete paraqitet e analizuar sipas pasqyres se mesiperme. Vlera 2,427,241,017 leke perbehet nga 2.416.856.526 leke albstar shqiperi, 10.384.491 leke mali zi.

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2018 Jane treguar ne pasqyren perkaloese.



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**3.5 Te ardhura nga shoqerite e kontrolluara dhe pjesmarrjet**

Nuk ka patur te ardhura dhe shpenzime te kesaj natyre per ushtrimin 2020 , por ka realizuar te ardhura dhe shpenzime nga filialet e saj te regjistruara ne Kosove dhe ne Mal te Zi.

**19. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)		
2	Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	(63,628,281.00)	75,225,312.00
3	Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)		
4	Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	-132,978,113.00	36,093,739.00
5	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		
<b>Shuma</b>		<b>(196,606,394)</b>	<b>111,319,051</b>

Jane paraqitur si diferenca e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**20. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Emertimi	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
<b>Shpenzimi Aktual i Tatim it m bi Fitim in</b>	<b>1,597,554,706</b>	<b>1,624,760,170</b>
<b>Fitim i/(Hum bja) Para Tatim it</b>		
Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-)	-	(1,329,655,210)
Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit		(1,329,655,210)
<b>Fitim i I tatushem / (Hum bja) Para Tatim it</b>	<b>1,597,554,706</b>	<b>295,104,960</b>
<b>Shpenzime te panjohura tatim ore(+)</b>	<b>10,022,829</b>	<b>4,439,320</b>
Shpezime prite e dhurime tej kufirit tatimor(+)		
Gjoba, penalitete, demshperblime(+)	10,022,829	4,439,320
Amortizim mbi normat fiskale(+)		
Provizione per rreziqe e shpenzime(+)		
Të tjera		
Diferencia pozitive - Shpenzimet tatim ore të lejuara minus njohjet për qëllimet e raportimit(-)		
Amortizimi i përshejtuar tatimor(-)	-	-
Të tjera(-)	-	-
Zbritja e humbjes tatim ore(-)	-	-
<b>Fitim i I Tatueshëm -Hum bja Fiskale(1+2+3+4+5)</b>	<b>1,607,577,535</b>	<b>299,544,280</b>
<b>Shpenzimi Aktual i Tatim it m bi Fitim in(2015-15%)</b>	<b>(242,710,366)</b>	<b>(45,170,121)</b>
<b>Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitim it të Shtyrë(+/-)</b>		-
<b>Shpenzime(të ardhura) për Tatim in m bi Fitim in(I+II)</b>		-
<b>Fitim i/(Hum bja) e Vtit Financiar</b>	<b>1,354,844,340</b>	<b>1,579,590,049</b>

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiscal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Fitimi i ushtrimit 1,354,844,340 leke perbehet nga fitim 1,608,046,278, leke Alb-Star Shqiperi dhe humbje(10491572) leke Mali Zi . Pra fitimi i tatueshem i konsolod 1,597.554.706 leke . Fitimi i tatueshem shqiperi 1,608,046,278 leke e korrektohet me shpezimet e panjohura per fiskun ne vlore 10,022.829 lek alb-star shqiperi Per Alb-Star shqiperi fitimi i tatueshem/ i korrektuar eshte 1.618.069.107 leke, Shpez i tatimit mbi fitimin 242,710,366 leke Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin jane respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal.Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15%

**4 Informacione shpjeguese për palët e lidhura**

Duke marre ne konsiderate te gjitha marredheniet e mundeshme me palet e lidhura, transaksionet e kryera me to, janë bërë sipas termave të njëjtë me ato që mbizotërojnë në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura.



**5 Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vijimësia**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk eshte evidentuar ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë miratuar nga drejtimi keto pasqyrat financiare, si per ngjarjet që mund te ekzistonin në datën e bilancit dhe per ato që jepin të dhëna pas datës së bilancit.

Pasqyrat financiare jane hartuar sipas parimit te vijimesise dhe nga informacionet e besueshme qe zoteron drejtimi nuk ka rreziqe të rëndësishme për të shkaktuar ç'rregullime materiale në vlerën kontabёl të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

**6 Te tjera informacione shpjeguese**

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2020 eshte rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar. Raportet e rentabilitetit per vitin 2020 jane: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) 29.58%, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 26.34 %. Ku albstar shpk rentabilitetit per vitin 2019, fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) 17.73 %, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 19.04 % Alb-Star shpk shqiperi per vitin 2020 Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) 29.76 %, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 26.51 %.



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEK)**

**15.1 Pasivet e kushtëzuara dhe anagazhimet kontraktuale të panjohura**

Drejtimi ka vleresuar se nuk ekzistojne ngjarje të shkuara apo angazhime kontraktuale të panjohura që mund te çojne ne te ardhmen, ne një detyrim i mundshëm ose të një pasivi te kushtëzuar dhe qe nuk jane ne kontrollin e shoqerise.

**15.2 Manaxhimi i Rrezikut Financiar**

Ne aktivitetin normal te biznesit shoqeria kryen transaksione te shumta me instrumenta financiare dhe per rrjetim eshte e ekspozuar ndaj rreziqeve te ndryshme financiare qe përfshijnë kryesisht riskun e kredise, riskun e likuiditetit dhe riskun e kursit te kembimit. Bazuar në informacionin e siguruar nga personeli drejtues rreziqet e mundeshme dhe metodat e menaxhimit te tyre jepen ne vijim.

**Rreziku i kredisë:** Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë kryesisht për shkak të faturimeve me likujdim te mevonshem ndaj klienteve te saj. Pjesa kryesore e keresave te arketueshme ne fund te ushtrimit i i perkasin enteve shteterore, pra qe kane financime buxhetore.

Bazuar ne pervojen e viteve te mepershemb, drejtimi vlereson se mundësia e humbjes në vlerën e tregut si rezultat i pamundësisë së klientit për të paguar borxhin eshte ne nivele shume te ulta.

**Rreziku i Kursit të Këmbimit :** Shoqeria ka filiale dhe dege ne Kosove dhe ne Mal te Zi , pra shoqeria kryen transaksione financiare ne keto dy vende pervec transaksioneve brenda vendit dhe mban ne llogarite e saj likuiditete ne monedhe te huaj.

Për shkak të kësaj, ndryshimet në kursin e këmbimit mund të ndikojnë në nivelin e performances per shkak te ndryshimit te kurseve te kembimit. Nga te dhenat qe zoteron drejtimi mendohet se kurset e kembimit nuk do ndryshojne shume per vitin ne vijim. Rreziku i këmbimit menaxhohet kryesisht duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve ne valute me detyrimet ne valute.

